



Prishtinë, 28 mars 2019  
Kodi i ZRRE-së: V\_1127\_2019

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Neni 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Neni 25, Nenin 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Nenin 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, Nenin 47 dhe Nenin 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 16 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Rregullën për vendosjen e të hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal (Rregulla për të Hyrat e FSHU);
- Dispozitat e rregullës për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe të Tregut (Rregulla për Të Hyrat e OST/OT);
- Dispozitat e rregullës për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (Rregulla për Të Hyrat e OSH);
- Vendimin e KOSTT-it nr. V\_1125\_2019 për të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulohen nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Tregut SH.A (KOSTT);
- Vendimin e OSSH-së nr. V\_1126\_2019 për të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulohen nga Operatori i licencuar i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH); dhe
- Aplikacionin/Kërkesën e KESCO/Furnizuesit me Shërbim Universal për përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara ,të dorëzuar më datën 21 janar 2019, në kuadër të Shqyrtimit Tarifave të Energjisë Elektrike me dokumentacionin relevant sqarues,

**në seancën e mbajtur më 28 mars 2019 nxori këtë:**

**V E N D I M**

- I. APROVOHEN TË HYRAT MAKSIMALE TË LEJUARA (HLM në tekstin e mëtejshëm: MAR) për Furnizuesin e Shërbimit Universal (FSHU/KESCO), për vitin relevant tarifar 1 prill 2019 -31 mars 2020 që do të mbledhen nga KESCO/FSHU përmes tarifave me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar.**



- II. Të Hyrat e Lejuara Maksimale të Furnizuesit me Shërbim Universal që mbulohen nga tarifat me pakicë të energjisë elektrike për vitin relevant tarifor do të jenë **248,823,503 euro**.
- III. Furnizuesi i Shërbimit Universal sipas këtij Vendimi udhëzohet t'i përgatis dhe dorëzoj në ZRRE propozimin për aprovim të tarifës së rregulluar me pakicë para vitit relevant tarifor.
- IV. Tarifat e propozuara nga i licencuari duhet ndjekur parimet e vendosura në Rregullën për vendosjen e të hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal (Rregulla për të Hyrat e FSHU).


## ARSYETIM

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) më datë 08 dhjetor 2018 ka iniciuar azhurnimet vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale për FSHU.
  - ZRRE me datën 21 janar 2018 nga KESCO - Furnizuesi i Shërbimit Universal, ka pranuar kërkesën për të Hyrat e Lejuara Maksimale, që Furnizuesi i Shërbimit Universal të lejohet të mbledhë nga tarifat me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar.
  - ZRRE me rastin e vendosjes për të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulohen nga FSHU ka marrë parasysh dokumentet që janë lëshuar dhe publikuar në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së:
    - Raport Konsultativ për të Hyrat e Lejuara Maksimale Furnizuesi me Shërbim Universal (prill 2019 - mars 2020), i publikuar më datë 22 shkurt 2019;
    - Raport Konsultativ - Përshtatjet vjetore të Të Hyrave të Lejuara Maksimale për KOSTT (prill 2019 - mars 2020), i publikuar më 22 shkurt 2019;
    - Raport Konsultativ - Përshtatjet vjetore të Të Hyrave të Lejuara Maksimale për KEDS (prill 2019 - mars 2020), i publikuar më 22 shkurt 2019;
    - Raport përfundimtar për Të Hyrat e Lejuara Maksimale të FSHU, Përgjigjet ndaj Komenteve (prill 2019 - mars 2020);
    - Raport përfundimtar për Të Hyrat e Lejuara Maksimale të OSTOT-së, Përgjigjet ndaj Komenteve (prill 2019 - mars 2020); dhe
    - Raport përfundimtar për Të Hyrat e Lejuara Maksimale të OSSH-së, Përgjigjet ndaj Komenteve (prill 2019 - mars 2020).
  - Bordi i ZRRE pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante dhe pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga palët, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
  - VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të zbatohet nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (KESCO) nga 01 prill 2019 deri në shqyrtimin e rregullt tarifor, dhe i njëjti do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

  
\_\_\_\_\_  
Arsim Janova, u.d. kryesues

  
\_\_\_\_\_  
Besim Sejrija, anëtar

  
\_\_\_\_\_  
Selman Hoti, anëtar

  
\_\_\_\_\_  
Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Furnizuesit me Shërbim Universal (KESCO), dhe
- Arkivit të ZRRE-së.